



## Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Të hënën, 9 tetor, u mbajtën seancat e paraqitjeve të para të Ismet Bahtjarit dhe të Sabit Januzit, në seanca për secilin më vete.

Z. Januzi dhe z. Bahtjari u arrestuan në Kosovë nga Zyra e Prokurorit të Specializuar të enjten e kaluar, në bazë të fletarrestimeve, urdhrave për transferim dhe aktakuzës së konfirmuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake i Dhomave të Specializuara të Kosovës. Ata u transferuan në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara në Hagë të premtën e kaluar.

Që të dy, Z. Januzi dhe z. Bahtjari akuzohen për frikësim dhe tentim për pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, përfshirë përmes kërcënimit të rëndë. Gjykatësi i Procedurës Paraprake konfirmoi aktakuzën e tyre më 2 tetor 2023 dhe versioni i redaktuar publik i saj gjendet në faqen e internetit të DHSK-ës.

Në aktakuzë thuhet se, midis më së paku 5 prillit dhe 12 prillit 2023, z. Januzi dhe z. Bahtjari u takuan secili me vete me një dëshmitar, për ta nxitur atë që të tërhiqte dëshminë ose të mos jepte dëshmi në proceset zyrtare para Dhomave të Specializuara të Kosovës, përfshirë përmes kërcënimit të rëndë.

Gjithashtu aty thuhet se z. Januzi dhe z. Bahtjari, në bashkëkryerje me individë të tjerë, u bashkërenduan si grup para dhe pas kontakteve personale me dëshmitarin.

Gjatë paraqitjes së parë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake siguron respektimin e të drejtave të të akuzuarve, përfshirë të drejtën për përfaqësim juridik, si edhe që të akuzuarit i kuptojnë akuzat e ngritura kundër tyre. Gjatë paraqitjes së tyre të parë të hënën, që të dy, z. Bahtjari dhe z. Januzi u vetëdeklaruan të pafajshëm në lidhje me të gjitha akuzat.

Konferenca e parë mbi ecurinë e çështjes gjyqësore *Januzi dhe Bahtjari* mbahet sot. Konferencat mbi ecurinë e çështjes janë seanca përgatitore që mbahen nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake për të vlerësuar ecurinë e çështjes gjyqësore, për të organizuar shkëmbime midis palëve dhe për të siguruar që palët të bëjnë të gjitha përgatitjet e nevojshme për gjykim në mënyrë të zellshme dhe në kohë.

Në çështjen gjyqësore *Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi*, janë mbajtur seanca gjatë gjithë javës.

Të hënën, 9 tetor, Prokuroria thirri dëshmitarin Nebojsa Radosheviq, i cili ishte gazetar i agjencisë serbe të lajmeve "Tanjug" gjatë periudhës përkatëse. Ai ishte dëshmitari i 28-ë i thirrur nga Prokuroria deri tani. Sipas përmbledhjes së shkurtër të dëshmisë që u lexua në sallën e gjyqit, Radosheviq u mbajt i ndaluar nga anëtarë

1





të UÇK-së në 1998, së bashku me fotografimin Vlladimir Dobriçiq. Dëshmia e z. Radosheviq vazhdoi edhe të martën dhe atij i bënë pyetje Prokuroria dhe ekipet e Mbrojtjes. Gjykatësit, po ashtu, i bënë pyetje dëshmitarit.

Të martën, 10 tetor, filloi dhënien e dëshmisë dëshmitari i 29-ë i thirrur nga Prokuroria; më tej u vijua në seancë private dhe seanca u shty. Në fillim të dëshmisë së këtij dëshmitari të mërkurën paradite, ai kërkoi të konsultohet me mbrojtësin kujdestar, i cili më pas iu drejtua gjykatësve në seancë private. Trupi Gjykses informoi mbrojtësin kujdestar të dëshmitarit për mundësinë e masave ndëshkimore sipas Rregullores dhe Ligjit në qoftë se dëshmitari i thirrur nuk paraqitet në gjyq ose nuk pranon të dëshmojë. Pas kësaj, Trupi Gjykses miratoi pjesërisht kërkesën e dëshmitarit për shtyrje të dhënies së dëshmisë dhe urdhëroi që dëshmia të rifillojë të hënën, më 16 tetor.

Pas tij, filloi dëshmia e dëshmitarit të 30-ë të thirrur nga Prokuroria. Ky është dëshmitar i mbrojtur i cili deri tani ka dhënë dëshmi kryesisht në seancë private. Sipas përmbledhjes të lexuar në sallë të gjyqit, dëshmitari është ish-anëtar i UÇK-së dëshmia e të cilit ka të bëjë, ndër të tjera, me strukturën komanduese të UÇK-së në Shqipëri dhe në zonën e Pashtrikut.

Në të njëjtën çështje gjyqësore, më 10 tetor, Trupi Gjykses miratoi kërkesën e Prokurorisë që një dëshmitar të dëshmojë përmes videokonferencës dhe më 11 tetor miratoi pjesërisht një kërkesë tjetër të Prokurorisë që edhe një dëshmitar tjetër të dëshmojë përmes videokonferencës.

Më 11 tetor, Trupi Gjykses miratoi kërkesën e Mbrojtjes së Krasniqit për pranimin si provë të një dokumenti shtesë që lidhet me dëshminë e një dëshmitari.

Gjithashtu, Trupi Gjykses miratoi kërkesën e Prokurorisë për kufizimin e kuadrit të marrjes në pyetje të dy dëshmitarëve në tema të caktuara, në bazë të rregullës 107. Kjo rregull përcakton se në qoftë se Prokuroria ka marrë informacion në mënyrë konfidenciale dhe vetëm për mbledhjen e provave të reja, informacioni nuk duhet të nxirret pa pëlqimin e dhënësit. Në qoftë se Prokuroria thërret dëshmitar në kuadër të kësaj rregulle, ajo mund të kufizojë edhe kuadrin e pyetjeve.

Seancat në çështjen gjyqësore *Thaçi dhe të tjerët* rifillojnë të hënën, 16 tetor, në orën 09:00 dhe janë planifikuar të vazhdojnë deri të enjten.

### **Pyetje nga gazetarët**

Nuk pati pyetje

